

## **Shtojca 1 e**

**Urdhrit mbi caktimin e datës për konferencë mbi ecurinë e çështjes**

**Publike**

## **Agjenda e konferencës mbi ecurinë e çështjes dhe/ose për parashtrimet me shkrim**

Të ofrohen informacione nga Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dhe Mbrojtja, sipas rastit:

### **1. Pyetje të përgjithshme:**

- a) Nëse hetimet e ZPS-së në këtë çështje janë në kryerje e sipër dhe, nëse po, nëse dhe si do të ndikojë kjo në kryerjen e shpejtë të procedurave;
- b) Sa është sasia e përgjithshme e provave që posedon aktualisht ZPS-ja dhe atyre që synon të përdorë për këtë proces;
- c) Në sa dëshmitarë është mbështetur ZPS-ja për Aktakuzën e Konfirmuar dhe a ka për qëllim të mbështetet në këta dëshmitarë gjatë gjykimit; dhe sa dëshmitarë synon të shtojë ZPS-ja në listën e dëshmitarëve për nevoja të gjykimit;
- d) Në qoftë se Mbrojtja dëshiron të kontribuojë në këtë fazë dhe pa paragjykuar të drejtat e të akuzuarit sipas Ligjit, informacion nëse Mbrojtja parashikon të kryejë hetime dhe sa kohë i duhet për të përfunduar hetimet e veta; dhe
- e) Në qoftë se Mbrojtja dëshiron të kontribuojë në këtë fazë dhe pa paragjykuar të drejtat e të akuzuarit sipas Ligjit, nëse mundet Mbrojtja të bëjë të ditur se a do të dorëzojë njoftim për alibi ose ndonjë arsye tjetër që përjashton përgjegjësinë penale.

### **2. Materiali i rregullës 102(1)(a) (Materiali mbështetës i Aktakuzës)**

- a) Sasia e përgjithshme e këtij materiali duke përfshirë edhe detaje (numri i deklaratave të dëshmitarëve, i deklaratave të marra nga i akuzuari, transkripteve, raporteve, dokumenteve të tjera, audiomaterialeve/videomaterialeve, fotografive, sendeve), përfshirë numrin e

përgjithshëm të faqeve dhe kohëzgjatjen e çdo audiomateriali/videomateriali, kur është e zbatueshme;

- b) Nëse përkthimi në shqip i deklaratave të dëshmitarëve të cilët ZPS-ja synon t'i thërrasë në gjykim është kryer ose, nëse këto deklarata janë duke u përkthyer, kur pritët që të kryhen përkthimet;
- c) Nëse materialet e rregullës 102(1)(a) duhet të redaktohen; dhe
- d) Nëse ZPS-ja është e gatshme t'i bëjë të njohur Mbrojtjes materialin sipas kësaj dispozite para afatit 30-ditësh që parashihet në rregullën 102(1)(a) të Rregullores.

### **3. Materiali i rregullës 102(1)(b) (Materiali shtesë që synohet të përdoret në gjykim)**

- a) Informacion nëse përpos materialit të rregullës 102(1)(a) të Rregullores ZPS-ja synon të nxjerrë material të rregullës 102(1)(b) të Rregullores, përfshirë:
- deklaratat e dëshmitarëve të cilët ZPS-ja synon t'i thërrasë për të dëshmuar në gjykim, përfshirë nëse përkthimet e tyre në shqip janë kryer ose, nëse këto deklarata janë duke u përkthyer, kur pritët që të kryhen përkthimet;
  - deklarata të dëshmitarëve të tjerë, aktekspertiza, deponime, apo transkripte që ZPS-ja synon t'i paraqesë në gjykim; dhe
  - prova materiale që ZPS-ja synon t'i paraqesë në gjykim.
- b) Nëse ZPS-ja synon të nxjerrë material të tillë, ajo bën të ditur sasinë e përafërt dhe llojin e këtij materiali, duke përfshirë numrin e faqeve dhe kohëzgjatjen e çdo audiomateriali/videomateriali, kur është e zbatueshme.

- c) Nëse materiali i rregullës 102(1)(b) ka nevojë të redaktohet; dhe
- d) Kur është ZPS-ja e gatshme që t'ia bëjë të njohur Mbrojtjes materialin sipas kësaj dispozite.

#### **4. Materiali i rregullës 102(3) (Materiali i provave për përgatitje të Mbrojtjes, që i është marrë ose i përkiste të akuzuarit)**

- a) Informacion nëse ZPS-ja synon të vërë në dispozicion të Mbrojtjes çfarëdo materiali që ka nën ruajtje ose kontroll sipas rregullës 102(3) të Rregullores, përfshirë çfarëdo deklarate, dokumenti, fotografie ose sendi tjetër të prekshëm që Mbrojtja i konsideron juridikisht thelbësore për përgatitjen e vet, ose që i janë marrë apo i përkisnin të akuzuarit;
- b) Nëse ZPS-ja ka material të tillë nën ruajtje apo kontroll, ajo bën të ditur llojin dhe sasinë përkatëse, duke përfshirë numrin e faqeve dhe kohëzgjatjen e çfarëdo audiomateriali/videomateriali, kur është e zbatueshme;
- c) Nëse materiali i rregullës 102(3) ka nevojë të redaktohet; dhe
- d) Kur është ZPS-ja e gatshme t'i japë Mbrojtjes një njoftim të hollësishëm për një material të tillë.

#### **5. Materiali i rregullës 103 (Provat shfajësuese)**

- a) Informacion mbi sasinë dhe llojin e materialit shfajësues sipas rregullës 103 të Rregullores, nën ruajtjen, kontrollin apo dijeninë faktike të ZPS-së deri më sot, duke përfshirë detaje (numri i deklaratave të dëshmitarëve, transkripteve, raporteve, dokumenteve të tjera, audiomaterialeve/videomaterialeve, fotografive, sendeve), përfshirë numrin e gjithsejtë të faqeve dhe kohëzgjatjen e çfarëdo audiomateriali/videomateriali, kur është e zbatueshme; dhe

- b) Nëse Prokurori zotëron material të tillë, a do të jenë të nevojshme redaktimet para nxjerrjes së menjëhershme të informacionit.

## **6. Materiali i rregullës 107 (Material i mbrojtur)**

- a) Informacion nëse ZPS-ja ka nën ruajtje apo kontroll material që synon ta paraqesë si provë që i është dhënë në mënyrë konfidenciale dhe vetëm për qëllimin e mbledhjes së provave të reja, gjithashtu të bëjë të ditur sasinë e përafërt dhe llojin e materialit, përfshirë numrin e faqeve dhe kohëzgjatjen e çfarëdo audiomateriali/videomateriali, kur është e zbatueshme;
- b) Në rast se ZPS-ja synon të nxjerrë material të tillë, nëse ky material është sipas rregullës 102(2) dhe/apo rregullës 103 të Rregullores;
- c) Informacion nëse, dhe për cilin material, ZPS-ja synon të kërkojë pëlqimin e dhënësve të informacionit dhe kur mund të pritët marrja e një pëlqimi të tillë; nëse ZPS-ja tashmë ka ndërmarrë hapa për të marrë pëlqimin e dhënësit të informacionit për të nxjerrë material të tillë, apo nëse parashihen hapa të tillë në të ardhmen e afërt;
- d) Informacion nëse ZPS-ja synon të kërkojë nga gjykatësi i procedurës paraprake të lirohet, tërësisht ose pjesërisht, nga detyrimi sipas rregullës 102 dhe 103 të Rregullores për të nxjerrë materialin fillestar;
- e) Informacion nëse do të ketë nevojë për redaktime nëse një material i tillë nxirret; dhe
- f) Informacion nëse do të kërkohet zbatimi i masave të tjera kompensuese në pajtim me rregullën 108(2) të Rregullores, përfshirë llojin e materialit që mund të preket, nëse material i tillë nuk mund të nxirret.

ZPS-ja dhe Zyra për Mbrojtje dhe Mbështetje të Dëshmitarëve (“ZMMD”) të ofrojnë informacione gjatë seancës *ex parte* të konferencës mbi ecurinë e çështjes, nëse mbahet një e tillë:

- a) Në rast se ZPS-ja synon të përdorë të njëjtët dëshmitarë në të cilët është mbështetur për Aktakuzën e konfirmuar, a janë shkëmbyer informacionet për këta dëshmitarë me ZMMD-në? Nëse jo, a do të shkëmbejë ZPS-ja këto informacione me ZMMD-në në të ardhmen e afërt? A parasheh ZPS-ja mundësinë e domosdoshmërisë së masave të tjera mbrojtëse për dëshmitarët në të cilët do të mbështetet gjatë gjykimit? A kanë nevojë dëshmitarët për mbrojtje dhe çfarë masash janë ndërmarrë për t’i mbrojtur ata;
- b) A ka dëshmitarë (të mundshëm) të ZPS-së në programin e DHS-së për mbrojtje? A janë zhvendosur ata “si masë parandaluese” nga ZPS-ja pa përfshirjen e ZMMD-së?
- c) A ka ndonjë çështje lidhur me mbrojtjen të cilën ZPS-ja dëshiron të ngrejë para gjykatësit të procedurës paraprake në këtë moment?
- d) A është ZPS-ja në gjendje t’i ofrojë gjykatësit të procedurës paraprake vlerësimet individuale mbi rrezikun për dëshmitarët mbi të cilët ZPS-ja synon të mbështetet gjatë gjykimit dhe/ose për të cilët ZPS-ja do të kërkojë anonimitet?